



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 62/004

Dt 20.01.2017

Në bazë të nenit 48 pika 1.3, nenit 154 dhe nenit 157 të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 19.1.2017, mori:

**VENDIM**

1. **Dr. sc. Eliza Avdiu** zgjidhet **profesor asistent** për lëndët: Shkathtësitë e mësimit akademik, Teori e mësimit, Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji, Praktika Pedagogjike (Fillor), në Fakultetin e Edukimit.
2. Zgjedhja e të përmendurës është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 157 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
3. E përmendura është e obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
4. Zgjedhja zgjat për periudhën 4 (katër) vjeçare.
5. Të përmendurës i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale të UMIB-it.
6. Kontrata e punës me të përmendurën do të lidhet prej 19.1.2017.

**Arsyetim**

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Shkathtësitë e mësimit akademik, Teori e mësimit, Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji, Praktika Pedagogjike (Fillor), në Fakultetin e Edukimit.

Komisioni i Studimeve e ka shqyrtuar raportin e Komisionit recensues dhe i ka propozuar Senatit të Universitetit që dr. sc. Eliza Avdiu të zgjidhet profesor asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 19.1.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për Studime, vendosi që dr. sc. Eliza Avdiu të zgjidhet profesor asistent për lëndët: Shkathtësitë e mësimit akademik, Teori e mësimit, Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji, Praktika Pedagogjike (Fillor), në Fakultetin e Edukimit.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurës;
3. Fakultetit;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit për paga;
6. Drejtorit të DAP.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it